



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 30.8.2012, e cila filloi në orën 12:00.

Në mbledhje morën pjesë: Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Fetah Salihu, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Liridon Restelica, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdriu, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja dhe Engin Beyoglu.

Munguan: Afërdita Veliu dhe Skënder Reçica.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE - së, të shoqërisë civile dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Aziz Pacolli** tha se sot është Dita Ndërkombëtare e Personave të Zhdukur, andaj do të ishte e rrugës që Kuvendi i Komunës të bënte një kërkesë, t'i drejtohej Bashkësisë ndërkombëtare që të ndihmojë në gjetjen e të zhdukurve.

Kryesuesi tha se, pasi që sot është Dita Ndërkombëtare e Personave të Zhdukur, si Kuvend, do ta marrim një qëndrim dhe me një kërkesë do t'iu drejtohem organeve gjegjëse.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

REND DITE:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë;**
- 2. Propozimvendimi për miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës;**
- 3. Propozimvendimi për miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave për raste sociale;**

4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme;
5. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit të investimeve kapitale për vitin 2012;
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për Ndërmarrjen Publike Banesore në lagjen "Pejton";
7. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për dhënien e parcelës kadastrore në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë - Menaxhmentit për Elektrikë, Logjistikë dhe Pronë (HM EL Zrt.) për ndërtimin e Qendrës Rekreative - Sportive 01 nr. 46 - 1064, të dt. 05.06.2009;
8. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për ndërrimin e palujtshmërisë - tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Prishtinës;
9. Propozimvendimi për plotësimin e Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoha komunale, 01 nr. 110 - 2782, të dt. 02.12.2011;
10. Propozimvendimi për emërimin e Këshillit të ekspertëve për planifikim;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Sadri Ramabaja bëri vërejtje në procesverbal dhe në ekstrakt të procesverbalit, duke thënë se nuk është pasqyruar qartas as në ekstrakt, as në procesverbal njëra prej çështjeve që e shtrova atë ditë. Fjalën e kam për kërcënimin që më është bërë nga ana e kryesuesit të Kuvendit, të paktën do duhej të ishte përfshirë në procesverbal. Ky është dokument. Dokumenti duhet të jetë krejtësisht autentik me atë se çka është folur këtu. Natyrisht, meqë nuk është prezantuar si duhet, nuk mund ta votoj.

Me shumicë votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës, kryesuesi hapi diskutimin.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimvendim dhe e vlerësojmë punën dhe detyrën e vështirë të Komisionit për caktimin e listës përfundimtare të përfituesve. Besojmë se në këtë listë janë të përfshirë të gjithë ata që i kanë plotësuar kriteret e parapara.

Ne, si Grup parlamentar i LDK-së, kërkojmë që çdo herë të verifikohen shfrytëzuesit e banesave, të cilët janë përfitues në të dy listat, dhe nëse dëshmohet që banesa shfrytëzohet me qira nga dikush tjetër, atëherë kjo e drejtë duhet t'iu merret shfrytëzuesve të këtyre banesave.

Grupi parlamentar i LDK-së e përkrah dhe do ta votojë këtë propozimvendim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se është diskutuar disa herë rreth këtyre banesave, por edhe ne e përkrahim propozimin e parafolësit që thotë këto banesa të shfrytëzohen prej atyre që janë shpallur përfitues të tyre dhe iu uroj atyre çdo të mirë.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë listë. Kjo listë nuk është aq e përkryer, por normalisht që janë meritore dhe grupi ynë parlamentar do ta votojë këtë listë, sepse kemi borxh ndaj këtyre kategorive dhe njerëzve që kanë kontribuar jashtëzakonisht për lirinë e Kosovës. I bashkëngjitëm grupit parlamentar të LDK-së dhe të AKR-së, që të jemi unik në këtë drejtim, që të respektohet Rregullorja në tërësi, dhe njëherësh komisionet e caktuara të bëjnë ndonjëherë verifikimin e atyre që do t'i shfrytëzojnë banesat, kështu që në këtë aspekt ne do të jemi pro kësaj liste.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, fillimisht tha se i përkrah ato qëndrime, të cilat u paraqitën nga përfaqësuesit e grupeve parlamentar të LDK-së, të AKR-së dhe të PDK-së, lidhur me shfrytëzimin e drejtë dhe konsekuent të këtyre banesave. Është bërë punë shumë e madhe, për çka e përgëzoj Komisionin, i cili nuk e ka pasur të lehtë përzgjedhjen e kandidatëve nga të gjithë ata që kanë aplikuar. Në veçanti përgëzoj gatishmërinë e Kuvendit komunal dhe të Kryetarit të Komunës, z. Isa Mustafa, që me këtë entuziazëm e filloi punën me ndërtimin e këtij kompleksi, e në veçanti për fjalët e dhëna për kompleksin që do të ndërtohet në të ardhmen.

Uroj që edhe në këtë aspekt të bëhet përzgjedhja sa më adekuate e njerëzve që e meritojnë.

Ne, si Grup parlamentar i AAK-së, e përkrahim në tërësi këtë listë, duke i potencuar edhe njëherë ato vërejtje dhe sugjerimet që u dhanë nga grupet parlamentare.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se me të vërtet shumë herë ne si Kuvend tregojmë një pjekuri të madhe, sepse për çështjet kryesore e gjejmë një gjuhë të përbashkët pozita dhe opozita. Falënderoj parafolësit për të gjitha ato që u cekën. Sa i përket punës dhe angazhimit të Komisionit, mund t'ju them se ka qenë vështirësi, por ka qenë edhe kënaqësi që t'iu shpërndahet atyre një shpërblim dhe një dhuratë e merituar, e cila edhe iu takon.

Ju falënderoj për përkrahjen, si Komision që kemi qenë, falënderoj Kuvendin edhe aprovimin e buxhetit për ndërtimin e komplekseve tjera për njerëzit me nevojë dhe për njerëzit me merita.

Si grup parlamentar, e përkrahim listën për miratim.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne e përkrahim ndarjen që është bërë, veçanërisht e përgëzoj Komisionin për një specifikim që sado pak na ka ofruar disa të dhëna, se ata që kanë kërkuar banesa a kanë qenë krejt meritore. Përfituesit i gëzofshin ato banesa! Besoj se ndarja është bërë si duhet, por le të përcillet përdorimi, gjegjësisht shfrytëzimit tyre.

E përkrahim këtë listë për miratim.

Sadri Ramabaja, Lëvizja Vetëvendosje, tha se nga ajo që u dëgjua nga parafolësit, shihet se ka një unanimitet rreth kësaj çështje dhe një vendim të tillë e përshëndes, por, për dallim prej kolegëve, kam një propozim tjetër më specifikues.

Në nenin 3 të vendimit potencohet se këto banesa iu jepen shfrytëzuesve me qira. Ngjashëm potencohet edhe në vendimin që iu jepet shfrytëzuesve që janë raste sociale. Kjo është arsyeja që më detyron që të bëjë një propozim konkret, që të ndryshohet neni 3 dhe, në bazë të këtij vendimi, Zyra e hipotekës do të duhej të bënte regjistrimin e këtyre apartamenteve si prona të përhershme të poseduesve konform Ligjit për pronën dhe pasurin e paluajtshme.

Nëse duam t'i trajtojmë në mënyrë specifike dëshmorët, familjarët, veteranët, atëherë nuk do të duhej që t'iu jepeshin me qira, por të kalonin në prona të tyre dhe t'iu themi familjarëve të tyre: I gëzofshi!

Në rast se nuk bëhet kjo tash, po iu paralajmëroj se në mandatin e ardhshëm, nëse Vetëvendosje ka shumicën, do ta marrë këtë vendim.

Lidhur me propozimin e z. Ramabaja, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Me shumicë votash, një abstenim (Sadri Ramabaj), u miratua Vendimi për miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës.

Pika e tretë

Kryesuesi hapi diskutimin për Propozimvendimin për miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave për raste sociale

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, shtoi se, meqë është i ndërlidhur me Propozimvendimin paraprak, atëherë ne e përkrahim për miratim edhe këtë propozimvendim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se po shihet se në këtë listë janë përfshirë emra, të cilët herën e parë kur janë ndarë banesat, kanë qenë shumë të zhurmshëm, kanë qenë këmbëngulës në kërkesat e tyre, për të cilët më vjen mirë që janë përzgjedhur.

Edhe ne e përkrahim miratimin e këtij propozimvendimi.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne e përkrahim këtë listë për miratim, por do të doja të ritheksoja edhe një herë, në kontest të kësaj, se është mirë që ne si Kuvend komunal, të mendojmë për bacën Adem, t'ia ndajmë një banesë, se është njëri prej atyre që e ka meritokracinë e pa kontestueshme, dhe besoj se asnjëri nuk do ta ndiente veten mirë që e treta apo e katërta herë që i bënë ndërtesat Komuna e Prishtinës.... Një vendim i tillë do t'i bënte nder këtij Kuvendi dhe, në anën tjetër, është legjendë e gjallë. Në kuadër të kësaj, pa e keqpërdorur, pa e bërë një digresion, ta marrim një vendim për një mbledhje të ardhshme që grupet parlamentare ta bëjmë një hap të qëlluar.

Për propozimin e z. Veseli, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se kjo pikë e rendit të ditës është plotësim i atyre katër banesave që nuk janë ndarë herën e kaluar.

Jemi plotësisht dakord për miratimin e këtij propozimvendimi, por edhe për pikat tjera, e kam fjalën që mos të ju marrim kohë të tjerëve, meqenëse janë shumë më tepër çështje teknike.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, tha se edhe ne e miratojmë këtë listë të propozuar.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se këtë listë e përkrahim dhe do ta votojmë për miratim.

Njëzëri u miratua Vendimi për miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave për raste sociale.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e pa luajtshme, kryesuesi paraqiti arsyet për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje.

Njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme.

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit të investimeve kapitale për vitin 2012

Xhelil Bektashi, drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, paraqiti arsyeshmërinë për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit të investimeve kapitale për vitin 2012.

Shemsi Veseli përshëndeti drejtorin dhe gjithë stafin e ekzekutivit që ka marr masa më përpara, që të marrim qëndrime dhe vendime rreth rishikimit të buxhetit konform asaj që në nivelin qendror veç është hapur edhe mundësia.

Një shqetësim që vlen të ceket, sidomos për mirëmbajtjen e pjesës së gjelbër të qytetit, sipërfaqeve gjelbëruese, është se vërtet jemi duke derdhur mjete dhe nuk po ka njëfarë suksesi në mirëmbajtje, kështu që është mirë dhe uroj që me këtë pozicion prej 200.000 € për mirëmbajtje, që Hortikultura të jetë më e përgjegjshme për shërbimin e saj, jo vetëm t'i mbjellë fidanët, por edhe t'i mirëmbajë.

Çështja e dytë është rreth planifikimit të buxhetit për vitin 2013. Në emër të Grupit parlamentar, kërkoj që të ndahen mjete më shumë, që mos të na pengojnë në realizimin e projekteve madhore, si të ndërtimit të rrugëve, siç është rruga "B", Unaza e qytetit etj. Pra, të ketë mjete materiale që do të jenë të mjaftueshme për ta kryer shpronësimin e nevojshëm.

Aziz Pacolli tha se edhe ne si grup parlamentar e votojmë këtë propozimvendim për miratim.

Me shumicë votash, një abstenim (Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit të investimeve kapitale për vitin 2012.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në lagjen "Pejton" Ndërmarrjes Publike Banesore, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Aziz Pacolli në emër të GP të AKR-së, shtroi pyetjen se çka do të bëhet me tregtarët, të cilët tash i kanë lokalet në atë pjesë. Kërkojmë që ata të kenë përparësi, që në të ardhmen të jenë shfrytëzues të atyre lokaleve.

Njëzëri u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për Ndërmarrjen Publike Banesore në lagjen "Pejton".

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për anulimin e vendimit për dhënien e parcelës kadastrore në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë - Menaxhmentit për Elektronikë, Logjistikë dhe Pronë (HM EL Zrt) për ndërtimin e Qendrës Rekreative - Sportive 01. nr. 46 - 1064, dt. 05.06.2009, kryesuesi tha se me rastin e disa ndryshimeve politike që kanë ndodhur në shtetin e Hungarisë, ka ndërruar niveli i menaxhmentit edhe në Ministri dhe për këtë çështje ata nuk kanë shfaqur interesim, andaj dhe duhet bërë anulimin e këtij vendimi.

Shemsi Veseli tha se Ministria e Mbrojtjes së Hungarisë nuk ka shprehur as gatishmëri, as vullnet. Janë në krizë financiare dhe nuk dëshirojnë të investojë, kështu që ky mbetet obligim ligjor që ne ta anulojmë këtë vendim.

Aziz Pacolli tha se me keqardhje po them se pas tri vjetëve, po mbesim pa të dy qendrat rekreative-sportive, d.m.th. edhe pronari i asaj pronës e ka ndërruar destinimin e objektit.

E përkrahim këtë që t'iu hiqet e drejta atyre, por me atë keqardhje që mbetëm pa asnjërinë qendër rekreative - sportive.

Njëzëri u miratua Vendimi për anulimin e vendimit për dhënien e parcelës kadastrore në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë - Menaxhmentit për Elektronikë, Logjistikë dhe Pronë (HM EL Zrt) për ndërtimin e Qendrës Rekreative - Sportive, 01. nr. 46 - 1064, të dt. 5.6.2009.

Pika e tetë

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin e Vendimit për ndërrimin e paluajtshmërisë - tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Prishtinës, arsyetimin për ndryshimin e këtij vendimi e paraqiti **Xhelil Bekteshi**.

Njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për ndërrimin e paluajtshmërisë - tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Prishtinës.

Pika e nëntë

Për Propozimvendimin për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110 - 2782, të dt. 2.12.2011, **Xhelil Bekteshi** paraqiti arsyetimin për plotësimin e kësaj rregulloreje.

Njëzëri u miratua Vendimi për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110 - 2782, të dt. 02.12.2011.

Pika e dhjetë

Lidhur me Propozimvendimin për emërimin e Këshillit të ekspertëve për planifikim, kryesuesi tha se në bazë të Ligjit për planifikim dhe ndërtim, është e përcaktuar që komunat duhet ta bëjnë, ta formojnë një komision, faktikisht është Komision i këshillit të ekspertëve për planifikim, që në kuptimin nuk është vendimmarrës, por është këshillëdhënës dhe është ndihmues i ekzekutivit.

Aziz Pacolli tha se kemi kërkuar që të jepet një biografi sado pak e shkurtër e këtyre personave, dhe të sqarohet se këta ekspertë a do të paguhen dhe prej kujt do të paguhen.

Shemsi Veseli shprehu urimin që tash e tutje ky ekip i ekspertëve, në aspektin profesional do të ndihmojë në planet rregulluese të Komunës së Prishtinës. Janë emra mjaft të njohur, të dëshmuar, shumica e tyre që mundën të kontribuojnë dhe të japin kontribut jashtëzakonisht të fuqishëm në interesin publik.

Si Grup parlamentar, këtë propozimvendim do ta votojmë për miratim.

Sadri Ramabaja tha se nga kjo përbërje vërehet se vetëm njëri nga anëtarët e këtij komisioni është profesor universitar. Do të ishte mirë që të na sillej biografia për secilin anëtar dhe gjithsesi në këtë përbërje të jenë edhe profesorët universitarë.

Me shumicë votash, një abstenim (Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për emërimin e Këshillit të ekspertëve për planifikim.

Pika e njëmbëdhjetë

Pyetje dhe përgjigje

Aziz Pacolli paraqiti shqetësimin e tij lidhur me zvarritjen e punëve që po ndodhin në shumë pjesë të qytetit, me theks të veçantë u përqendrua tek parku i qytetit "Tauk-bahçe". Lidhur me këtë, në shtyp po shkruajnë se aty ka probleme pronësore, andaj kërkoj të dijë se në cilat pjesë të parkut të qytetit "Tauk-bahçe"

kemi probleme pronësore dhe kur pritet që të përfundojnë punët, se vërtet janë duke u zvarritur shumë.

Lidhur me shqetësimin e z. Pacolli, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Sadri Ramabaja parashtrroi dy pyetje:

1. Dua të jem i informuar me procedurat që janë ndjekur për punimet në dy sheshet ekzistuese. Nga Drejtoria e Kadastrit kërkoj informacion për sipërfaqen, sa metra katrorë janë, për procedurën e tenderimit etj.
2. Kërkoj përgjigje nga drejtoria përkatëse se sa hektarë, arë, metra, centimetra tokë publike janë uzurpuar, duke filluar nga shkolla "Mileniumi i Tretë", deri te vila "Panorama".

Për këto pyetje, pres përgjigje me shkrim.

Pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale:

Tefik Mehmeti, në emër të banorëve të fshatit Shkabaj, paraqiti shqetësimet lidhur me rrugën që qon për në këtë lokalitet, duke shtuar se pas përfundimit të rrugës, ka filluar me të madhe heqja dhe vjedhja e kapakëve të hekurit të sistemit të kanalizimit, andaj dhe po krijohen shumë probleme gjatë udhëtimit nëpër atë rrugë.

Naime Osmani tha se disa herë me radhë kam bërë pyetjen drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike, dhe për këtë dua t'i informoj kolegët se asnjë herë nuk më është kthyer përgjigje dhe asnjëherë, asnjë pyetje e imja apo kërkesë e imja që është bërë për kërkesat e qytetarëve, nuk është realizuar. Drejtori më ka thënë se përgjigjet janë kthyer në Kuvend, por ato tek unë nuk kanë ardhur asnjëherë.

Shaip Hajrizi parashtrroi dy pyetje:

Pse nuk po realizohet premtimi i dhënë lidhur me mbushjen e gropës afër varrezave? A planifikohet të mbulohet ajo gropë dhe të evitohet rreziku për ato shtëpi?

Kjo është kërkesë edhe e qytetarëve, që më kanë obliguar ta them.

Afër shkollës së re "Eqrem Çabej", mendohet të punohet një projekt. Është shqetësuese për mua, për të tjerët dhe për drejtorin e asaj shkolle, se rreth shkollës është plotësisht i panevojshëm betonimi që është bërë.

Dua të di se a ka pasur mundësi që, së paku rreth shkollës, të mbetj gjelbërimi që ka qenë.

Rexhep Mustafa, mbetet që pyetjet ti dorëzoj me shkrim

Rrahman Ismajli, kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës.

Kërkesën e paraqes edhe në emër të qytetarëve.

Kërkojmë që rruga "1 Tetori" të rregullohet. Kjo është një rrugë e pakalueshme, tash e disa vjet, në qendër të qytetit.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Ismajli, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Mejreme Berisha u përqendrua në dy çështje:

1. Tani veç po fillon viti shkollor, 1 shtatori, dhe më intereson se çfarë do të bëhet me ata nxënës, të cilët ende nuk kanë arritur të ulen nëpër bankat e shkollës së mesme.

2. Disa herë kam bërë një kërkesë apo një pyetje organeve kompetente. Është fjala për rrugën “Dëshmorët e Marecit”, e cila është një rrugë shumë e ngushtë. Është e pamundur që aty të kalojnë dy automjete në një drejtim. Nuk ka ditë që nuk bëhet ndonjë ndeshje. Le të dalin organet kompetente e t’i bëjnë ato rrugë njëkahore, se vërtet nuk ka ditë që nuk dëmtohen makina, por më shqetësuese është se në atë rrugë po rrezikohen fëmijët, pasi që aty afër janë shkollat. Andaj, ju lutem, unë nuk di se kujt t’i drejtohem për këtë çështje.

Për pyetjet e parashtruara nga znj. Berisha, Kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Naim Makolli paraqiti shqetësimin lidhur me një tollovië që ka ndodhur që dy muaj e tepër në rrugën “Vëllezërit Fazliu”, gjegjësisht prej Xhamisë së Llapit e deri te rruga e Sharbanëve. Ditëve të fundit, sigurisht organi kompetent ka bërë disa pika të ndahet rruga në tri korsi, por apeloj që kjo të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

Edhe stacioni te Xhamia e Llapit, stacioni i autobusëve, shumë qytetarë mendojnë se ky stacion duhet të hiqet nga stacionet ndërrurbane dhe të mbetet vetëm stacion urban, sepse aty krijohen tollovi shumë të mëdha.

Bekim Gashi paraqiti shqetësimin e qytetarëve të Hajvalisë rreth uzurpimit të 40 hektarëve, ku aty-këtu ka edhe ndërtime. Tash ka filluar edhe shit-blerja e tyre me një çmim shumë të ulët.

Kërkoj nga organet përkatëse të vendosin një shenjë atje që është pronë komunale dhe t’i qesin pikat, në mënyrë që qytetarët të mos jenë pre e matrapazëve të ndryshëm.

Shefqet Sylejmani paraqiti një kërkesë, që çështjet e shtruara prej tij në mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa, të barten edhe si çështje të shtruara në Kuvend.

Ai tha se këtu është duke u rrënuar diç për të mirë, andaj nuk guxojmë që t’i lejojmë vetes që të bindemi nga propagandat e ndryshme. Do të ishte mirë që organet kompetente komunale të kenë kujdes gjatë dhënies së afatit dhjetëvjeçar të shfrytëzimit të pronës komunale, ngase ai mund të tejkalohet.

Kërkoi që t’i bëhet trysni Komisionit komunal për ndarjen e pasurisë – banesave që i takojnë komunës dhe pjesës tjetër që i takon koncesionarit, në kompleksin banesor “Dielli”, të punojë, pasi që ka shumë keqpërdorime dhe nuk ka kurrfarë shërbimesh. Është mirë që të hapet bunar dhe të rregullohet terreni sportiv në këtë kompleks.

Kërkoi që të bëhet vizatimi i vijave të bardha në dy korsitë e rrugës, lartë dhe poshtë, te Xhamia e Llapit, në mënyrë më kualitative, pasi që ato po fshihen shumë shpejt. Njëherësh pyeti se Komisioni mbikëqyrës për semaforë inteligjentë, a paguhet nga ana e investitorit, si dhe a është e vërtetë që kompania ka lënë

mundësi që t'i komandojë këta semaforë nga zyra dhe a do të vazhdohet me vënien e tyre edhe në dy – tri vende, duke propozuar që kjo të bëhet.

Hetem Kupina, pyetje për Drejtorinë e Financave dhe Pronës:

Lus drejtorinë në fjalë që të na sjellë të dhëna për tokën, gjegjësisht trojet e ndara nga ky Kuvend pjesëtarëve të UÇK-së, në vendin e quajtur Bardhosh. Janë ndarë 47 troje. Cili është statusi i atyre trojeve?. A janë dhënë ato troje në shfrytëzim, apo me të drejtë tjetërsimi?

Kërkoj nga kjo drejtori që përgjigjet të më kthehen me shkrim.

Pika e dymbëdhjetë

Të ndryshme

Kryesuesi tha se çështja e të zhdukurve në fillim është iniciuar nga z. Aziz Pacolli, andaj dhe ishte propozim i tij që me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, nga ky Kuvend të dalë një deklaratë, njëherësh do të jetë një kërkesë edhe për institucionet vendore, për Komisionin e të pagjeturve dhe për institucionet qendrore dhe ato ndërkombëtare, që të bëhet më shumë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

Mbledhja mbaroi në orën 13:30.

PROCESMBAJTËSI
Zijadin Gashi

KRYESUESI I KUVENDI
Sami Hamiti, ecc. i dipl.